



Nr. 1663/1 Prot

01.20.03.23

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr.207/1 prot.

Shkodër, më 16.03.2023

Lënda: Mbi Vendimin Nr.9, datë 27.02.2023 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave funksionale të ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin”, neni 8, shkronja “a”, të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, të ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 14/5, neni 27/1, neni 64, shkronja “c”, shkresës së Agjencisë Kombëtare Ujësjellës Kanalizime & Infrastrukturës së Mbetjeve nr.67/2, datë 06.02.23, Marrëveshjes së përbashkët mes 4 (katër) bashkive dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr.1283 Prot, datë 02.02.23 shqyrtoi VKB Nr.9, datë 27.02.2023 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës “Mbi miratimin e marrëveshjes për krijimin e subjektit të përbashkët në zbatim të VKM Nr.302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”.

Prefekti lejon procedim të mëtejshëm në zbatim të VKM Nr.302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK



VENDIM

Nr. 09 Datë 27.02 2023

“Për miratimin e Marrëveshjes për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjellës-Kanalizimeve datë 19.01.2023, lidhur ndërmjet Bashkisë Vau-Dejës dhe Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës dhe Bashkive Malësi e Madhe, Pukë dhe Fushë-Arrëz”

Në mbështetje të Nenit 113 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Nenit 9, Pikës 1 dhe 5 të Nenit 14 të Ligjit Nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtarët”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 302, datë 11.05.2022, “Për Politikat Kombëtare për Riorganizimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit, Trajtimit dhe Përpunimit të Ujërave të Ndotura”; Marrëveshjes për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjellës – Kanalizimeve datë 19.01.2023, lidhur ndërmjet Bashkisë Vau-Dejës, dhe Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës, dhe Bashkive Malësi e Madhe, Pukë dhe Fushë-Arrëz; Shkresën e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, AKUM, Nr. 67/2 Prot, datë 06.02.2023, “Për Miratimin e Marrëveshjes SKP-UK në Këshillin Bashkiak”, pasi shqyrtoi përmbajtjen dhe kushtet e parashtruara në marrëveshje, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak:

VENDOSI:

1. Miratimin e Marrëveshjes për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjellës-Kanalizimeve datë 19.01.2023, lidhur ndërmjet Bashkisë Vau-Dejës, dhe Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës, dhe Bashkive Malësi e Madhe, Pukë dhe Fushë-Arrëz.
2. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e tij si aksionar i vetëm i shoqërisë “Ujësjellës-Kanalizime Vau Dejës”, sh.a, që në përputhje me kushtet dhe dakordësinë e arritur në Marrëveshjen për krijimin e Subjektit me Kompetenca të Përbashkëta të Ujësjellës-Kanalizimeve datë 19.01.2023, që pas krijimit të Subjektit me Kompetenca të Përbashkëta ku

Bashkia do të jetë aksionare, të vijojë me miratimin në Asamblenë e Përgjithshme të Aksionarëve të autorizimit për Administratorin e shoqërisë "Ujësjellës-Kanalizime Vau Dejës" sh.a, për nënshkrimin e çdo akti të nevojshëm kontraktor dhe noterial me qëllim transferimin e plotë të veprimtarisë ekonomike, duke përfshirë asetet që shoqëria aktualisht ka, tek shoqëria e re aksionare SKP-UK që do të krijohet.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas Nenit 55 të Ligjit Nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar.

KRYETAR

Mark BISHA

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Ardian ÇELEPIJA

Miratuar me 19 vota

Vota Pro 19

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 03.03.2023